



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA – PREDSIEDNIK

DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr.03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik;

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes mbi Ndhmën e Ndërsjellë Ligjore në Çështjet Penale, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e nënshkruar me 08 prill 2011, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 06 maj 2011.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-010-2011

Prishtinë, më 09 qershor 2011



Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës

MARRËVESHJE
NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
MBI
NDIHMËN E NDËRSJELLË LIGJORE NË ÇËSHTJET PENALE

PREAMBULA

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë; këtej e tutje të referuara si "Palët";

Në aspiratat e tyre për zhvillimin dhe forcimin e e mëtutjeshëm të marrëdhënieve bilaterale në frymën e miqësisë ekzistuese dhe bashkëpunimit në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale në mes të Dy Palëve;

Duke marrë në konsideratë dëshirën për pjesëmarrje aktive në procesin e bashkëpunimit në Evropë, dhe me qëllim të realizimit efikas të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të shtetasve tonë;

Gjithashtu me qëllim të promovimit të marrëdhënieve të gjithanshme dhe bashkëpunimit mes Dy Palëve;

Janë pajtuar si në vijim:

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Ofrimi i Ndhmës Juridike të Ndërsjellë

1. Palët marrin përsipër t'i ofrojnë njëra tjetrës, sipas kërkesës, masat më të gjera të ndihmës së ndërsjellë ligjore në procedurat lidhur me çështjet penale, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuar me këtë Marrëveshje.

2. Ndihma ligjore do të ofrohet nga gjykatat dhe autoritetet tjera të Palëve sipas ligjeve të tyre, të cilat janë kompetente të vendosin mbi rastet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 2

Fushëveprimi i ndihmës

Bashkëpunimi duhet të përfshijë ndihmën e ndërsjellë ligjore në çështjet penale si: vendndodhjen dëshmitarëve, sigurimin e të dhënave lidhur me personat që janë nën hetime dhe hetimin e veprave penale të cilat nuk parashohin ndonjë masë me anë të së cilave e detyrojnë ndonjë person që të përgjigjet në pyetje, dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve mjeko ligjor si dhe personave të tjerë, njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve në çështjet penale, shkëmbimi i të dhënave ose materialeve të tjera gjatë hetimit dhe procedurave penale, sigurimin e informatave lidhur me të dhënat penale, kontrollimi i objekteve dhe personave, përcjellja e akteve, materialeve të shkruara dhe provave tjera lidhur me procedurën penale në Palën kërkuese, si dhe transferimi dhe marrja e ndjekjes penale.

Neni 3

Kanalet dhe gjuha e komunikimit

1. Kërkesat për ndihmë juridike të ndërsjellë do të dorëzohen me shkrim, përmes Ministrisë së Drejtësisë së të dy palëve.

2. Kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë dhe aktet tjera përcjellëse të bashkëngjitura do të dërgohen në origjinal apo kopje të vërtetuara.

3. Kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë do të përpilohet në gjuhën e palës kërkuese, për Republikën e Kosovës-në gjuhën Shqipe ose Serbe si dhe për Republikën e Maqedonisë-në gjuhën Maqedone.

4. Shkresat e bashkëngjitura me kërkesën për ndihmë juridike të ndërsjellë do të përpilohen në gjuhën e Palës kërkuese dhe duhet të bashkëngjiten përkthimi i vërtetuar në gjuhën e Palës së kërkuar, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë Marrëveshje.

5. Aktet në përputhje me kërkesën për ndihmë juridike të ndërsjellë të dërguar shtetasit e Palës kërkuese me vendqëndrim në territorin e Palës së kërkuar nuk do të thotë që duhet bashkëngjitur përkthimin në gjuhën e Palës kërkuese, nëse marrësi pajtohet me këtë.

6. Shkresat lidhur me veprimin sipas kërkesës për ndihmë juridike të ndërsjellë do të përpilohen në gjuhën e Palës së kërkuar.

Neni 4 Përmbajtja e kërkesës

1. Kërkesa për ndihmë ligjore të ndërsjellë do të përmbajë për aq sa është e mundur:

1) emrin e autoritetit të palës kërkuese i cili e ka bërë kërkesën për ndihmë juridike të ndërsjellë, dhe nëse është e mundshme edhe emrin e autoritetit të kërkuar;

2) përshkrimi i rastit për të cilën ndihma juridike në çështjet penale është kërkuar si dhe përshkrimi ligjor i veprës penale;

3) lënda dhe qëllimi i kërkesës për ndihmë juridike të ndërsjellë;

4) deklarata mbi të dhënat e nevojshme për zbatimin e procedurës për ofrimin e ndihmës juridike;

5) emri dhe mbiemri i palëve në procedurë, të dhëna mbi datën dhe vendin e lindjes, vendbanimin e përkohshëm apo të përhershëm, shtetësinë, si dhe emrin dhe vendndodhjen e personave juridik;

6) përshkrimi i shkurtër i shkresave dhe provave të kërkuara nëse është e nevojshme;

2. Ndihma ligjore do të ofrohet në pajtim me ligjin e palës së kërkuar.

3. Kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë, si dhe aktet e tjera përcjellëse duhet të jenë të nënshkruara dhe vulosura nga Pala kërkuese.

Neni 5 Refuzimi i ndihmës juridike të ndërsjellë

1. Kërkesat për ndihmë juridike të ndërsjellë mund të refuzohen nga Pala e kërkuar në ndonjërin nga rastet në vijim:

1) Nëse kërkesat për ndihmë juridike të ndërsjellë kanë të bëjnë me:

- Vepër penale të cilën Pala e kërkuar konsideron se është vepër penale politike ose që ka lidhje me vepër penale politike; ose

- Vepër penale ushtarake e cila nuk përbën vepër penale sipas ligjit penal të aplikueshëm;

2) Pala e kërkuar mund të refuzojë ofrimin e ndihmës juridike nëse konsideron se ekzekutimi i kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë paragjykojnë sovranitetin e saj apo sigurinë, ose do të ishte në kundërshtim me rendin e tij juridik.

- 3) Nëse dyshohet se ekzekutimi i një kërkesë të tillë është në kundërshtim me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.
 - 4) Çdo vendim për refuzimin e ndihmës juridike të ndërsjellë duhet të arsyetohet.
2. Veprat e lartcekura penale nuk do të konsiderohen vepra penale politike ose vepra penale të lidhura me një vepër penale politike, nëse hetimi dhe procedura për veprat e tilla penale është e detyrueshme për Palët Kontraktuese sipas marrëveshjeve shumëpalëshe dhe ndërkombëtare.

Neni 6

Veprimi mbi Kërkesat

1. Nëse Pala e kërkuar konstaton se kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje ose nuk mund të ekzekutohet sipas ligjeve të saj, Pala do të informojë menjëherë Palën kërkuese dhe të shpjegojë arsyet për këtë.
2. Pas refuzimit të kërkesës për ndihmë juridike të ndërsjellë, Pala e kërkuar do t'ia kthejë kërkesën origjinale Palës kërkuese së bashku me të gjitha dokumentet, informatat apo provat e siguruara.
3. Nëse autoriteti të cilit i drejtohet kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë nuk është kompetent për të vepruar, zyrtarisht, do të përcjellë kërkesat për ndihmë juridike të ndërsjellë autoritetit kompetent të vendit të tij.

KAPITULLI II

Neni 7

Letër porositë

1. Çdo Palë Kontraktuese mund t'ia përcjellë autoriteteve kompetente të Palës tjetër letërporosinë, me qëllim të sigurimit të provave si marrjen në pyetje apo deklaratave nga dëshmitarët apo ekspertët dhe përcjelljen e dokumenteve dhe shkresave nga provat e siguruara.
2. Nëse Pala kërkuese kërkon nga dëshmitarët apo ekspertët dhënien e dëshmive nën betim, shprehimisht duhet ta cekë në kërkesën e tij dhe Pala e kërkuar do të pajtohet me një kërkesë të tillë nëse nuk është në kundërshtim me ligjin e vendit të tij.
3. Nëse pala kërkuese kërkon ekzekutimin e letër porosisë përmes video konferencës, duhet që kërkesa të behet me shkrim, dhe se Pala e kërkuar duhet të përmbush një kërkesë të tillë nëse nuk është në kundërshtim me ligjin e tyre vendor dhe ka në posedim mjetet e nevojshme për këtë shërbim.

Neni 8

Ekzekutimi i Letër Porosive

1. Pala e kërkuar do të ekzekutojë Letërporosinë lidhur me çështjet penale dhe të drejtuara tek ajo nga Pala kërkuese, në përputhje me procedurën e zakonshme dhe mënyrën e përcaktuar me ligjet e veta.
2. Pala e kërkuar mund të zbatohet, sipas kërkesës, një procedurë të veçantë të kërkuar nga Pala kërkuese në ekzekutimin e Letërporosisë, deri në atë masë sa një procedurë e tillë është në përputhje me ligjet e Palës së kërkuar.
3. Nëse Pala kërkuese kërkon një gjë të tillë shprehimisht, Pala e kërkuar do të njoftojë datën dhe vendin e ekzekutimit të letërporosisë. Autoritetet dhe personat e interesuar mund të jenë të pranishëm në ekzekutimin e letërporosisë nëse Pala e kërkuar pajtohet.
4. Kërkesat për prezencën e këtyre autoriteteve apo personave të interesuar mund të mos refuzohet në rast se prezenca e tillë ka për qëllim ekzekutimin e letërporosisë për nevojat e Palës kërkuese dhe mundëson shmangien e kërkesave tjera për ndihmë juridike të ndërsjellë.

Neni 9

Dorëzimi dhe kthimi i dokumenteve dhe provave të marra

1. Pala e kërkuar mund të vonojë dorëzimin e provave, të dhënave apo dokumenteve të kërkuara, nëse është e nevojshme lidhur me procedurën penale që është në pritje.
2. Te gjitha dokumentet dhe ato origjinale të cilat janë dorëzuar për ekzekutimin e letërporosisë, do të kthehen nga ana e palës kërkuese tek pala e kërkuar, vetëm nëse pala e kërkuar nuk e merr parasysh kthimin e tyre.

KAPITULLI III

Letërthirrjet ose urdhëresat në sigurimin e dokumenteve dhe gjërave

Neni 10

Shkresat ose urdhëresat gjyqësore në sigurimin e dëshmive me zbatimin e masave detyruese

1. Pala kërkuese mund të dorëzojë tek pala tjetër shkresat apo urdhëresat e lëshuara nga gjykata e saj penale tek gjykata kompetente e palës së kërkuar, duke kërkuar që të sigurojë dëshmitë e shënuara në shkresa ose urdhëresa, nëse është e nevojshme, të zbatohen masa të detyrueshme të lejueshme sipas ligjeve të palës së kërkuar.

2. Secila palë kontraktuese ka të drejtë në shërbimin e dokumenteve për shtetasit e tij në territorin e shtetit të palës së kërkuar përmes misionëve diplomatike apo konsullore.

Neni 11

Përmbajtja e shkresave apo urdhëresave në sigurimin e dëshmive

1. Shkresat dhe urdhëresat gjyqësore në sigurimin e dëshmive do të përfshijnë:

- 1) emrin e autoritetit i cili e parashton kërkesën; dhe
- 2) emrin, adresën dhe shtetësinë e personit, të cilit i drejtohet shkresa apo urdhëri.

Neni 12

Ekzekutimi i aktgjyqimeve të huaja në çështjet penale

Në përputhje me këtë Marrëveshje, të dyja palët do të njohin dhe ekzekutojnë aktgjykimet në çështjet penale të lëshuara nga Gjykatat kompetente të Palës kërkuese, në pajtim me ligjin e aplikueshëm vendor.

Neni 13

Transferimi i përkohshëm i personave në ndalim në territorin e palës kërkuese

1. Personi i ndaluar, paraqitja personale e të cilit bëhet me qëllim të sigurimit të provave tjera e jo për gjykim që është kërkuar nga pala kërkuese do të transferohet përkohësisht në territorin e saj me kusht që ai /ajo do të kthehet brenda periudhës së përcaktuar nga pala e kërkuar.

2. Transferi mund të refuzohet:

- 1). nëse personi i ndaluar nuk pajtohet;
- 2). nëse prezenca e tij/saj është e domosdoshme në procedurën penale në pritje në territorin e palës së kërkuar;
- 3). nëse transferimi rrezikon zgjatjen burgimit të tij/saj; ose
- 4). nëse ekzistojnë baza thelbësore për mos transferimin e tij/saj në territorin e Palës kërkuese.

Neni 14

Dorezimi dhe marrja përsipër e ndjekjes penale

1. Nëse shtetasi i ndonjëres Palë ose personi me vendbanim në territorin e tij ka kryer veprë penale në territorin e Palës tjetër e cila është e dënueshme sipas ligjit të të dy Palëve, Pala në të cilën është kryer vepra mund të kërkojë nga Pala tjetër të marrë përsipër ndjekjen penale

2. Autoritetet kompetente të Palës së kërkuar do të zhvillojnë procedurën penale në pajtim me ligjet e asaj Pale.

Neni 15

1. Në letërporosinë për ndërmarrje të ndjekjes penale duhet të përshkruhen faktet mbi rastin dhe të përfshihen sa më shumë që është e mundur të dhëna për të akuzuarin, shtetësinë e tij ose saj, dhe vendqëndrimin apo vendbanimin.
2. Letërporosisë do t'i bashkëngjiten si në vijim:
 - 1). dokumentet origjinale ose kopjet e vërtetuara;
 - 2). prova për shtetësinë, vendbanimi i personit për të cilin është kërkuar ndërmarrja e ndjekjes penale;
 - 3). ekstrakte nga dispozitat e Kodit Penal të Palës kërkuese i cili është i aplikueshëm në çështjen penale;
 - 4). deklaratat nga ana e palëve të dëmtuara të cilat pajtohen me marrjen përsipër të ndjekjes penale.
3. Nëse pala e kërkuar nuk pranon letërporosinë për ndërmarrjen e ndjekjes penale do të njoftojë menjëherë palën kërkuese dhe do t'i kthejë dokumentet e bashkëngjitura me letërporosi.

Neni 16

1. Autoritetet gjyqësore të palës kërkuese përkohësisht do të heqin dorë nga ndjekja lidhur me veprat penale të cekura në letërporosi për ndërmarrjen e ndjekjes penale. Sidoqoftë nga masat e tilla do të heqin dorë nëse:

1) gjykata kompetente ose autoriteti kompetent i Palës së kërkuar Kontraktuese përfundimisht heq dorë nga ndjekja penale për shkak të mungesës së provave apo për shkak se vepra penale nuk konsiderohet vepër penale;

2) i akuzuari është liruar nga Pala e kërkuar me një vendim të plotfuqishëm;

3) vendimi i gjykatës i cili është lëshuar nga pala e kërkuar veçse është ekzekutuar ose nuk ka vend për ekzekutim sipas ligjit, ose për shkak të aktit të faljes ose amnistisë, ose nëse sipas ligjit të palës së kërkuar ka ardhur deri te parashkrimi.

Neni 17

Pala e kërkuar Kontraktuese do ta njoftoj Palën kërkuese për rezultatin e procedurës penale lidhur me letërporosinë për ndërmarrjen e ndjekjes penale dhe më pas do ta përcjellë vendimin origjinal të plotfuqishëm ose kopjen e vërtetuar.

Neni 18
Transferi i sigurt

Personi, pavarësisht nga kombësia e tij/saj, i cili është ftuar para autoriteteve të Palës kërkuese që të përgjigjet për veprat që përbëjnë ndjekjen penale kundër tij/saj, nuk mund të ndiqet penalisht ose të mbahet në gjendje arresti ose t'i nështrohet ndonjë mase tjetër kufizuese për lirinë e tij/saj individuale për vepra ose dënime që janë kryer para nisjes së tij/saj nga territori i palës së kërkuar e që nuk specifikohet në letër-thirrje.

KAPITULLI IV

Dispozitat Përfundimtare

Neni 19
Mbrojtja e të dhënave

1. Të dhënat personale të dërguara nga njëra palë tek pala tjetër si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së përpiluar sipas kësaj marrëveshje, mund të përdoret nga pala të cilës i janë përcjellur të dhënat e tilla vetëm:
 - 1) Për qëllimet e procedurës të cilat i takojnë kësaj marrëveshje;
 - 2) Për procedura tjera gjyqësore dhe administrative lidhur drjetëpërdejt me procedurën e referuar nën (1);
 - 3) Me qëllim të parandalimit të një kërcënimi serioz dhe të drejtpërdrejtë për sigurinë publike.
2. Për më tepër, të dhënat e tilla mund të përdoren për çfarëdo qëllimi tjetër nëse paraprakisht ekziston pajtimi nga ana e palës që ka bërë përcjelljen e të dhënave apo nga personi për të cilin kanë të bëjnë ato të dhëna.
3. Secila nga palët mund të refuzoj përcjelljen e të dhënave personale të siguruara si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së përpiluar sipas kësaj Marrëveshje;
 - 1) kur të dhënat e tilla janë të mbrojtura sipas legjislacionit vendor, dhe
 - 2) kur palës së cilës duhet t'i përcillen ato të dhëna nuk është i obliguar sipas Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Procesimin Automatik të të dhënave personale, të miratuar në Strasbourg më 28 Janar 1981, përveç nëse pala e fundit zotohet që të ofrojë një mbrojtje të tillë të të dhënave siç është kërkuar nga pala paraprake.
4. Secila nga palët që përcjell të dhëna personale të siguruara si rezultat i ekzekutimit të një kërkesë të përpiluar sipas kësaj marrëveshje, mund të kërkojë nga pala tjetër së cilës i janë përcjellur ato të dhëna, të njoftojë lidhur me mënyrën e përdorimit të të dhënave të tilla.

KAPITULLI V

Dispozitat tjera

Neni 20

Përcjellja e informatave mbi vendimet

1. Secila nga palët do ta njoftojë palën tjetër për gjitha vendimet penale dhe masat pasuese lidhur me shtetasit e palës së fundit, të regjistruar në të dhënat gjyqësore. Ministrinë e Drejtësisë do të bëjnë përcjelljen e këtyre informatave tek njëri-tjetri së paku një herë në vit. Aty ku personi në fjalë konsiderohet se ka dy apo më shumë shtetësi, informatat do t'iu ofrohen secilës nga palët, përveç nëse personi nuk është shtetas i palës në territorin e të cilit ai ose ajo është dënuar.
2. Sidoqoftë, secila nga palët e cila i ka dërguar informatat e sipërpërmendura do t'i përcjell palës tjetër, me kërkesë të tij, kopjet e vendimeve dhe masave në fjalë, e poashtu të gjitha informatat tjera përkatëse që lidhen me to dhe me pikëpamjen që të mundësojë të realizohen nëse këto rezultate nevojiten për ndërmarrjen e masave në nivel kombëtar. Ky komunikim do të bëhet nëpërmjet Ministrive të Drejtësisë në fjalë.

Neni 21

Shpenzimet

1. Palët nuk do të kërkojnë kompensimin e shpenzimeve si rezultat i aplikimit të kësaj Marrëveshje, përveç për:
 - 1) shpenzimet që bëhen nga prania e ekspertëve në territorin e palës së kërkuar;
 - 2) shpenzimet që dalin nga transferimi i personit në arrest sipas nenit 13 të kësaj marrëveshje;
 - 3) shpenzimet më të konsiderueshme ose të jashtëzakonshme.
2. Megjithatë, shpenzimet për pagesën e përkthyesve, dhe shpenzimet që ipen për dëshmitarët dhe shpenzimet e udhëtimit të tyre në Palën e kërkuar do të kompensohen nga pala kërkuese, vetëm nëse palët pajtohen ndryshe.
3. Palët do të konsultojnë njëra tjetrën lidhur me përcaktimin e kushteve për pagesën e shpenzimeve që do të mund të kërkohen në pajtim me dispozitat nën paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të mosmarrëveshjeve gjatë implementimit të dispozitave të kësaj marrëveshje, e njëjta duhet të zgjidhet përmes rrugëve diplomatike.

KAPITULLI VI

Dispozitat përfundimtare

Neni 23 Shtrirja e efektit


Dispozitat e kësaj marrëveshje lidhur me të gjitha kërkesat për ndihmë juridike të ndërsjellë do të aplikohen lidhur me aktet dhe veprat penale të kryera pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.

Neni 24 Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje do t'i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.
2. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas 30 ditëve pas pranimit të njoftimit të fundit me të cilën palët kontraktuese do ta njoftojnë njëra tjetrën lidhur me procedurën e ratifikimit të zhvilluar në pajtim me ligjin vendor.
3. Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Secila nga palët kontraktuese mund ta ndërpresë marrëveshjen me shkrim nëpërmjet rrugëve diplomatike. Në rast të tillë, marrëveshja pushon së vepruari 6 muaj pas datës së njoftimit të tillë.

E përpiluar në Prishtinë, më 8 prill 2011, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën Shqipe, Maqedone dhe Angleze, me tekst të njëjtë autentik. Në rast të ndonjë ndryshimi në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR
QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



PËR
QEVERINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

